



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

THIRRJE PUBLIKE

Për Mbështetje Financiare Publike të Organizatave Jo-Qeveritare në Zbatimin e Aktiviteteve të Kulturës dhe Sportit

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Gjakovës, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës dhe të Sportit, të aplikojnë me projektet/programet e tyre në fushat prioritare si në vijim:

- Të gjitha OJQ-të në Komunën e Gjakovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës.*
- Të gjitha OJQ-të, Klubet Aktive Sportive në Komunën e Gjakovës të cilat janë të licencuara dhe programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Sportit.*

3. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte të cilat do të kontribuojnë në zbatimin e programit të DKRS, si më poshtë:

- Aktivitetet që kanë për qëllim ruajtjen, ngritjen, nxitjen dhe përcjelljen e frymës së Kulturës dhe Sportit tek shoqëria civile e më gjerë;
- Bashkëpunimi i institucioneve publike dhe akterëve tjerë me shoqërinë civile për nxitjen dhe promovimin e aktiviteteve në fushën e Kulturës dhe Sportit.
- Organizimi i aktiviteteve për shënimin e ngjarjeve të ndryshme me rëndësi në fushën e kulturës dhe sportit;
- Mbështetja e aktiviteteve të përgjithshme Kulturore dhe Sportive;
- Avancimi dhe promovimi i vlerave të mirëfillta në fushën e Kulturës dhe Sportit.

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 195,000.00 euro. Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve, shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një (1) projekt është 500 euro, ndërsa shuma maksimale për një (1) projekt është 40.000 euro.

5. Aplikantët dhe partnerët potencialë, për pjesën tjetër të kostove mund të sigurojnë bashkëfinancim nga donatorët dhe burimet tjera publike apo burimet vetanake.

6. Afati për dorëzimin e propozimeve fillon nga data 24.04.2025 dhe përfundon me datën: 16.05.2025

KOMUNA E GJAKOVËS

7. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti me dy (2) projekte në kuadër të kësaj thirrje, por vetëm një (1) projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.
8. Periudha e zbatimit të projektit është brenda vitit.
9. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga llojet e fushës dhe aktiviteteve të përfshira në kuadër të kësaj thirrje publike.
10. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare.
11. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një (1) vit para datës së publikimit të thirrjes publike. (të prezantohet certifikata e numrit fiskal, certifikata e regjistrimit dhe kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar).
12. Së bashku me aplikacionin, OJQ-të janë të obliguara të paraqesin dëshminë e Vërtetimit Tatimor të ATK-së, Letër konfirmimin ku vërtetohet që OJQ-ja është e regjistruar në Departamentit për OJQ-Ministria e Punëve të Brendshme dhe Vërtetimin e Gjykatës Ekonomike të OJQ-së.
13. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komuna e Gjakovë / Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ([kk.rks-gov.net/gjakove/](http://kk.rks-gov.net/gjakove/)).
14. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Rr. "UÇK" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi".
15. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues të zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.
16. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
17. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS-së.